

NJOFTIM

Qendra e Personel Rekrutimit, do të rekrutojë **1 (një)** kandidat për të ndjekur “**Kursin e titullimit të Oficerit të Forcës Tokësore**”, i cili do të zhvillohet në Akademinë Mbretërore të Forcës Tokësore në Sandhurst, në Britaninë e Madhe, në periudhën 13 qershor 2023 - 9 gusht 2024.

Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit pranë Qendrës së Personel Rekrutimit është deri në 8 mars 2023.

1. Kriteret e pranimit të kandidatëve:

- Të jetë shtetas shqiptar.
- Të mos jetë dënuar nga gjykata për vepra penale.
- Të mos jetë në ndjekje penale.
- Të mos jetë në proces gjykimi penal nga gjykata.
- Të mos ketë probleme me deportimin.
- Të mos jetë përdorues i lëndëve narkotike dhe alkolit, për të cilat do të paraqesin testet e kryera.
- Të mos jetë person i dyshuar nga organet e zbatimit të ligjit për veprimtari të kundërligjshme apo kriminale.
- Të jetë në moshë jo më shumë se 27 vjeç, në momentin e titullimit (1 shtator 2024, sipas ligjit nr. 59/2014, “Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura).
- Të jetë **ushtarak/civil** (rekrut, ushtarë, nënoficerë dhe nëntogerë të rinj të cilët nuk kanë kryer kursin bazë të oficerit), të cilët kanë përfunduar minimumi studimet “bachelor”, brenda ose jashtë vendit, të njohur dhe ekuivalentuar nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve të Republikës së Shqipërisë.
- Të ketë notën mesatare të lëndëve të të gjitha viteve të arsimit të lartë (bachelor), jo më pak se 7 (shtatë).
- Kandidatët duhet të zotërojnë gjuhën angleze, mbi 71 pikë në testimin ALCPT ose nivelin 2/2/2/2 sipas STANAG 6001.
- Të ketë gjatësinë trupore jo më pak se 165 cm për meshkujt dhe jo më pak se 160 cm për femrat.
- Të mos jetë i martuar
- Të jetë i aftë të notojë 100 m.
- Të mos jetë bartës i virusit HIV, Hepatit B dhe SST (Sëmundje Seksualisht të Transmetueshme); të mos ketë kaluar apo të vuajë nga sëmundje të zemrës, veshkave, hepatite, pulmonare, neuropsikiatrike, sistemit lokomotor (sistemit kockor dhe lëvizjes) apo të ketë qenë ose të jetë përdorues i lëndëve narkotike.
- Të rezultojë kalues në testet fizike, shëndetësore, intelektuale, gjuhsore ose trajnuese, që zhvillohen nga vendet partnere në vendin tonë ose pranë akademive ushtarake jashtë vendit, me qëllim pranimit në akademi.
- Të mos jetë i larguar nga puna në administratën qendrore ose vendore (nëse ka qenë i punësuar para aplikimit), për shkelje të dispozitave të kodit të punës ose legjislacionit në fuqi. Kjo kërkesë aplikohet për kandidatët që nuk janë pjesë e FA.
- Të ketë një trup me fizik të rregullt, të shëndetshëm nga të gjitha pikëpamjet, pa asnjë mangësi apo shenja që deformojnë pamjen.
- Të jetë shpallur fitues në përfundim të konkurimit.
- Të plotësojë kushtin e sigurisë.
- Të jetë vlerësuar i aftë për të shërbyer në FA gjatë ekzaminimit mjekësor në Njësinë Mjekësore Ushtarake.

- Kandidatët që rekrutohen nga radhët e Forcave të Armatosura përveç kriterëve të mësipërme duhet të plotësojnë edhe kriteret e mëposhtme:
 - a. Të kenë vlerësimin e punës jo më pak se “shumë mirë”;
 - b. Të mos kenë asnjë masë disiplinore në fuqi.
- Kandidatët nuk mund të regjistrohen për ndjekjen e studimeve në institucionet arsimore ushtarake jashtë vendit, në rast se:
 - a. Kanë kryer më parë të njëjtin nivel arsimor ushtarak brenda ose jashtë vendit.
 - b. Kanë qenë kontingjent i Forcave të Armatosura për ndjekjen e studimeve ushtarake brenda dhe jashtë vendit dhe nuk i kanë përfunduar ato.
- Kandidati që nuk plotëson qoftë edhe një nga kriteret e përmendura më sipër, s’kualifikohet.

2. Dokumentet për regjistrim:

Kandidatët për regjistrim duhet të paraqesin pranë zyrës së pranimit në Qendrën e Personel Rekrutimit, Tiranë, dokumentacionin e mëposhtëm:

- Kërkesë me shkrim e nënshkruar nga kandidati për ndjekjen e studimeve ushtarake në **“Kursin e titullimit të Oficerit të Forcës Tokësore”**, që do të zhvillohet në Britaninë e Madhe.
- Formular me të dhënat personale sipas formatit të përcaktuar, **ANEX A**.
- Fotokopje e noterizuar e dokumentit zyrtar (diplomës) që vërteton përfundimin e arsimit të lartë (minimumi bachelor) së bashku me listën e notave.
- Fotokopje e kartës së identitetit.
- Fotografi për dokument (4x6), 2 (dy) copë.
- Fotokopje të pasaportës e vlefshme për jashtë shtetit.
- Raport i aftësisë në punë të lëshuar nga mjeku i familjes i qendrës shëndetësore së vendbanimit, i shoqëruar edhe me një raport shpjegues, ku deklarohej se kandidati është i shëndetshëm, nuk ka sëmundje kronike, infektive, të shëndetit mendor në anamnezën e tij personale dhe nuk është përdorues i lëndëve narkotike.
- Ekzaminimet mjekësore për agjentët infektivë (Hepatitin B, C dhe D, HIV/AIDS, Sifiliz), grupin e gjakut dhe lëndët narkotike të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut ose bangat e gjakut apo drejtoritë e Shëndetit Publik në prefekturat apo rrethet ku banojnë, si dhe testet për lëndët narkotike nga laboratorë të certifikuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
- Formularët e vetëdeklarimit që plotësohen në momentin e aplikimit pranë zyrës së pranimit në Qendrën e Personel Rekrutimit, për gjendjen shëndetësore dhe për procedim penal ose jo, si dhe është ose jo i dënuar.

Dokumentacioni që duhet të paraqesin kandidatët e kualifikuar brenda 10 ditëve pas përfundimit të testimit:

- Dëshmi penaliteti.
- Vërtetim nga gjykata.
- Vërtetim nga prokuroria.
- Vërtetim nga përmbarimi.
- Ekzaminimet për agjentët infektivë (Hepatit B, Hepatit C, Hepatit D, HIV/AIDS, Sifiliz) dhe raportin mjekësor të lëshuar nga komisioni mjeko-ligjor, në Njësinë Mjekësore Ushtarake.
- Testet për lëndët narkotike të lëshuar nga laboratorë të certifikuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

3.Datat e testimit:

Testi Fizik:	09.03.2023
Testi Intelktual:	09.03.2023
Testi Psikologjik:	10.03.2023
Testi i Gjuhës së Huaj (anglisht):	10.03.2023

4. Të dhënat e testimit të Aftësive Fizike:

- **Vrapim 2 km, për 10 min e 15 sek.**
- **Hedhje në largësinë 3.1 m e topit me peshë 4 kg.**
- **Tërheqje peshe 76 kg deri në lartësinë e gjunjëve.**

QENDRA E PERSONEL REKRUTIMIT